



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 06, Datë 10.01.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K., NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, gërma “c” dhe nenit 83 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 4, pika 1, gërma “c”; nenit 5; nenit 8; nenit 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma “f” dhe nenin 10, pikat 1 dhe 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror”, si dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, ERE në mbledhjen e tij të datës 10.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.125/5 Prot, datë 13.01.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën nr. 3051 prot., datë 12.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 810 prot., datë 12.12.2019, ka aplikuar për pajisjen me licencë në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë).
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar në zbatim të ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarur dhe privatizimit”, i ndryshuar/ligjit nr. 7667, datë 28.01.1993, “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen plotësuar nga shoqëritë tregtare”, regjistruar si person juridik shqiptar, me vendimin e Gjykatës së Tiranës, nr. 674/1 akti, datë 05.07.1993 dhe mban numrin e identifikimit (NUIS) J61820031J.
- Objekt i veprimtarisë së saj është: Import eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të Energjisë Elektrike, Gazit Natyror etj..
- Nga shqyrtimi që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, rezulton si më poshtë vijon:
- Neni 9, pika 1 gërma a, b, c, e (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor). Plotësuar.

gërma “d” plotësuar pjesërisht. Shoqëria GSA sh.p.k ka deklaruar se do të përdorë rrjetin e transmetimit të gazit të Trans Adriatic Pipeline (TAP). Shoqëria ka paraqitur në ERE statutin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., (vërtetim i njësisë me origjinalin, me nr. Rep. 2945, datë 10.12.2019) dhe mbetet të depozitohet në ERE Aktin e themelimit dhe Certifikatën e regjistrimit të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

Mungon gërma “e” (ii). Subjekti “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE Pasqyrat financiare të audituara, për vitet 2017 dhe 2018 nga të cilat rezulton një bilanc pozitiv. Do të kërkohej shoqërisë të depozitohet në ERE edhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016.

Mungon gërma “e” (vi), Planin e Biznesit. Do të kërkohej shoqërisë të depozitohet në ERE Planin e Biznesit.

Mungon gërma “e” (vii). Nëse Aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tija ditore ai duhet të informojë ERE për këtë synim dhe të japë një Garanci të Performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi. Do të kërkohej shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Neni 9, pika 2 (i), (ii), (iii), Subjekti ka bërë përshkrimin e sasisë mesatare të gazit natyror të parashikuar për të livruar, garancinë mbi cilësinë e gazit si dhe dokumentuar kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit, duke plotësuar kërkesat e kësaj dispozite.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**